



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSIME E BUXHETIT
DREJTORIA E STREHIMIT

Nr. 773 / Prot.

Tiranë, më 15/11/2021

Lënda: Mbi fondet për programin e strehimit për vitin 2021

BASHKISË _____

Nëpërmjet kësaj shkrese ju bëjmë me dije mbi fondet e planifikuara për shpenzimet korrente, për programet e strehimit, për vitin 2021, si edhe ju informojmë mbi afatet e aplikimit dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

Buxheti për shpenzimet korrente, për programet e strehimit për vitin 2021 në total është 1,809 milion lekë, i ndarë në 203 milion lekë për subvencionimin e interesave të kredive, 6 milion lekë për grant të menjëhershëm dhe 1,600 milion për bonusin e qirasë, nga ku 1,500 milion lekë janë planifikuar për familjet e prekura nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019.

Ndarja dhe përdorimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korrente, për strehimin, në vitin 2021 do të synojë:

- Lehtësimin, për qytetaret, e blerjes së banesave me kosto të ulët nëpërmjet subvencionimit të interesave të kredisë dhe grantit të menjëhershëm;
- mbështetjen financiare për subvencionimin e pagesës së qirasë për familjet e pastreha, sipas ligjit nr.22/2018, si dhe për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore të tërmetit;
- angazhimin e njësisë të vetëqeverisjes vendore, duke rritur kontributin e përgjithshëm në bashkëfinancimin e programeve të subvencionimit.

Tabela nr. 1 bashkëlidhur, paraqet një përmbledhëse indikative mbi fondet për programet e subvencionimit që do të hapen gjatë vitit 2021.

Informacioni i plotë mbi kushtet për të përfituar fonde dhe formatin e aplikimit për subvencionimin e qirasë dhe grantin e menjëhershëm, që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitin 2021, është përmbledhur në Shtojcën "A", e cila është publikuar në faqen e Ministrisë, në adresën: <http://financa.gov.al/drejtoria-e-strehimit/>.

Afati i dorëzimit të kërkesave për subvencionimin e qirasë dhe grantin e menjëhershëm është data 31.01.2021.

Për çdo pyetje a sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni në adresën e email-it: Boriana.Hasanllari@financa.gov.al.



Tabellë 1. Financimi i programeve të subvencionimit, për strehimin, për vitin 2021

	Gjithësej
Subvencionet gjithësej, nga të cilat:	1,809,000,000
a. Subvencionimi i interesave të kredive, nga të cilat:	203,000,000
- Kredi në vazhdim	151,200,000
- Kredi të reja	51,800,000
b. Subvencionimi i qirasë financiare për Tiranën dhe Vlorën	15,000,000
c. Subvencionimi i qirasë	85,000,000
ç. Subvencionimi i qirasë për të prekurit nga tërmeti	1,500,000,000
d. Grant i menjëhershëm	6,000,000